

VENDIM
Nr. 234, datë 21.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË ARSIMIT DHE
SPORTIT, PËR UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, FAKULTETI I
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, TË PJESËS SË
NDËRTESES SË ISH-INSTITUTIT TË STUDIM-PROJEKTIMIT NR. 1 TIRANË, ME
NUMËR PASURIE 4/590, ME SIPËRFAQE NDËRTESESË DHE TRUALL 1555 m², NË
ZONËN KADASTRALE 8260, PÛRKATËSISHT OBORRIN DHE KATIN E PARË, NË
PËRDORIM NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME DHE DREJTORIA RAJONALE E
ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE TIRANË DHE NË ADMINISTRIM TË MINISTRISË
SË ZHVILLIMIT URBAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të objektit me numër pasurie 4/590, me sipërfaqe 1 555 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) m², ndërtesë dhe truall, që ndodhet në zonën kadastrale 8260, përkatësisht oborrin e brendshëm dhe katin e parë, i cili, aktualisht, është në përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Tiranë dhe në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Urban.

2. Sipërfaqja e përgjithshme (ndërtesë dhe truall) në përdorim të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike ndryshon nga 2 360 (dy mijë e treqind e gjashtëdhjetë) m² në 3 915 (tre mijë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë) m², ku përfshihet edhe oborri i brendshëm, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.


3. Universiteti Politeknik i Tiranës nuk mund ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANIMETRITË AKTUALE TË OBJEKTIT




PLANVENDOSJA

PLANI I KATIT PERDHE



PLANI I KATIT PARE



 Kujtë i përcaktuar si objekt në përdorim nga F&E
 Kujtë i përcaktuar si objekt në përdorim nga F&E